



PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË TAKIMIT

KËSHILLI KOMBËTAR PËR EKONOMI DHE INVESTIME (KKEI)

DISKUTIM MBI ZBATIMIN E LIGJIT No. 08/I-125 PËR PRONËN PULIKE

Prishtinë, 11 dhjetor 2024, 09:30 – 12:00

Takimi u moderua nga Drejtuesi i Sekretariatit Artan Mehmeti. Në takim morën pjesë 23 pjesëmarrës, që ishin përfaqësues të bizneseve vendore dhe institucioneve shtetërore në Kosovë.

Fjalët hyrëse

Artan Mehmeti, Sekretariati, KKEI, në fjalën e tij hyrëse përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit që janë bashkuar në raundin e pestë të takimeve sektoriale për këtë vit. Vazhdoi tutje duke shpjeguar për rëndësinë e Sekretariatit të Këshillit Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI), që është një platformë e dialogut publik-privat që synon të afrojë institucionet publike me sektorin privat dhe të përmirësojë klimën investuese, qeverisjen dhe transparencën.

Sekretariati mbështetet nga SECO përmes Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH).

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës

Me 19 qershor, APK ka nxjerrë një vendim me të cilin ka pezulluar të gjitha kërkesat që i kanë bizneset lidhur me shfrytëzimin e tokës - bllokadë totale e punës. Poashtu, KPMM



nuk vazhdon të lëshojë licenca, nuk jep lejen e minimi, tashmë që këto kompetenca i kanë kaluar Njesisë brenda ZKM-së.

Pas shumë takimeve me aktetë relevante, nuk është arritur ende zgjidhje konkrete. Minimumi do të ishte të vazhdohej një periudhë tranzitore që të vazhdojë zbatimi i ligjit sic ka qenë. Kemi dhjetëra biznese anëtare të cilat e kanë ndërprerë operimin, duke rezultuar në humbjen e shumë vendeve të punës në sektorin minerar. Kjo çështje kërkon trajtim emergjent.

Pasojat që do të ketë vendi janë nëse vazhdohej kështu, do të jetë humbja e qindra mijëra vendeve të punës, e që ky sektor është thelbësor për ekonominë e vendit. Prandaj, do të ishte mirë të zhvillohej një takim urgjent që të zgjidhet kjo çështje.

- Nëse problemi nuk zgjidhet shpejt, do të na duhet të dalim publikisht të flasim rreth problemeve tona. Mund të ndërmarrim masa më rigoroze, por nuk jemi të interesuarar t'i kontribuojmë përkeqësimit të kësaj gjendje.

Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Jemi të vetëdijshëm që ekziston kjo problematikë. Kemi diskutuar me MBPZHR se Ligji për Pronën Publike është në kolizion me shumë ligje tjera në fuqi, pavarësisht se ka qenë në Kuvend për kohë të gjatë. I kemi kërkuar edhe komisionit parlamentar që të bëjë plotësim-ndryshimin e ligjit, por akoma nuk ka pasë ndonjë lëvizje.

- **Pyetje MDA:** Kolizioni në fjalë, a është i natyrës teknike, apo duhet të rregullohet përmes Kuvendit?
- **Përgjigje e ZKM-së:** Çështja është te Neni 32.2 që thotë: "Të gjitha Ligjet duhet të jenë në përputhshmëri me këtë ligj". Për më shumë rreth kësaj, sponzorizuesi i këtij ligji - Ministria e Drejtësisë - mund të ofrojë shpjegime shtesë për këtë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)



Ligji i Pyjeve (Neni 8.1) përcakton se me tokat pyjore menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës. Fakti se tash sipas Ligjit për Pronën Publike krijohet Njësia e cila *administron* me pronën publike, krijon paqartësi edhe tek Ministria. Tash është krijuar një vakum, që u pamundëson bizneseve të zhvillojnë aktivitetet e tyre.

Propozoj që sa më shpejtë të bëhet ndryshim-plotësimi i këtij ligji dhe të bëhet harmonizimi me ligjet në fuqi.

- DHTIK pajtohet që ky ndryshim-plotësim të bëhet urgjent. Do të mjaftonte vetem një nen që e lejon të vazhdojë procedura si ka qenë deri sa të funksionalizohet.

Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK)

- Shumë sektorë janë blloku me hyrjen në fuqi të këtij ligji, por sektori minerar po pëson më së shumti.
- Më 31.5.2024 kemi kërkuar opinion ligjor nga ZKM për këtë bllokadë të shkaktuar. Me 6 qershor kemi pranuar përgjigje, dhe është konstatuar që ka kundërshtime mes Ligjit për Pronën Publike dhe Ligjit për Pyje. Për këtë është sugjeruar që MD dhe MBPZHR të bëjnë harmonizimin e këtyre dy ligjeve dhe njëkohësisht të bëhet ndryshimi në Kuvend. Ka pasë indikacion që në Kuvend është vështirë të ndryshohet.
- Në shtator kemi parashtruar kërkesë, pas të cilës ZKM i drejtohet Zyrës Ligjore të MD për opinion ligjor. Konstatimi i MD ka qenë që ky është ligj i mirë dhe duhet të zbatohet.
- As ZKM, as MD nuk kanë filluar hartimin e akteve nënligjore për fillimin e njësisë. Ne poashtu kemi propozuar që nenit 6 t'i shtohet një paragraf, dmth paragrafi 7, i cili do të thoshte: *“Pronat me të cilat menaxhon Agjencia Pyjore e Kosovës janë prona publike të shtetit të Kosovës dhe të cilat rregullohen me Ligjin për Pyje”*.
- Janë tejkalluar 100 operatorë të cilëve i'u kanë skaduar kontratat me APK.



- ZKM është organ epror, dhe mund të japë një orientim. Duhet të diskutohet se kush nga këto organe është kompetent për të ndërmarrë dëkka. Duhet të bëhet zgjidhje për këtë çështje.

Ministria e Drejtësisë (MD)

Së fundi e kemi kuptuar që ligji ka probleme në zbatim, gjë që është problem i madh.

Një pasqyrë e shkurtër e procesit për nxjerrjen e këtij ligji:

- Hartimi i projektligjit ka zgjatë me vite.
- Paraprakisht është përgatitë një koncept dokument për ta analizuar materien.
- Në 2019 është miratuar në Qeveri, në Kuvend është dorëzuar në 2020.
- Strategjia Kombëtare e të Drejtave Pronësore e miratuar në Qeveri në vitin 2016 e ka përcaktuar nevojën e hartimit të këtij ligji. Në këtë strategji kanë punuar mbi 140 zyrtarë të niveleve të ndryshme, ekspertë të huaj dhe vendor, si dhe akterë të ndryshëm që kanë punuar në këtë fushë. Pas një pune dyvjeçare, ajo strategji është miratuar në qeveri, dhe ka filluar të prodhojë efekte juridike në kuptim të nisjes së ligjeve.
- Në tetor të 2015 është lidhë MSA, prej të cilës është kërkuar që Kosova të ketë ligj të veçantë që rregullon pronën publike. Këtu ka qenë sfidë që qytetarëve të BE-së, t'u jepen të drejta të barabarta me qytetarët e Kosovës. MD ka përgatitë ligj të veçantë për të drejtën e blerjes së pronave nga ana e qytetarëve të BE-së dhe kompanive të BE-së si dhe qytetarëve të huaj.
- Në 2011 është parapa të themelohet një zyre e veçantë në ZKM për administrimin e pronave, si kërkesë e BE-së. Atë vit është themeluar ajo zyre, por fatkeqsisht gati që asnjëherë nuk ka qenë tërësisht funksionale shkaku i numrit të vogël të stafit, e që ka qenë 1-2 persona. Tash ajo zyrë nuk është fare funksionale.

Kur një akt hyn në fuqi dhe dalin probleme në zbatim, atëherë institucionet duhet të reagojnë. Gjatë takimit është përmend problematika e mosfunksionalizimit të Njësisë. Ajo Njësi asnjëherë nuk është themeluar. Po ashtu, Qeveria duhet të nxjerrë akt të veçantë nënligjor të veçantë për të funksionalizuar Njësinë.



- Me Nenet 18 dhe 29 të ligjit, është themeluar grupi punues për këto akte nënligjore.

MD ka lëshuar dy opinione ligjore, dhe ka dhënë mendim, përderisa i mungojnë aktet nënligjore.

- Në një rast të ngjashëm, GJEDNJ ka thënë se shtetet anëtare duhet të zbatojnë në raste të tilla dispozitat e ligjeve të vjetra, përderisa ligjet e reja nuk mund të zbatohen. Për shkak se këtu kemi të bëjmë me sigurinë juridike.

Si propozim konkret, MD propozon amandamentimin me urgjencë të këtij ligji.

APK

Dispozita e nenit 32 të Ligjit për Pronën Publike nënkupton se nuk mund të ndermirret ndonjë veprim që është në kundërshtim me këtë ligj, dhe se në rast të kolizionit, ky ligj zbatohet mbi tjerët. Për zbatimin e kësaj dispozite, APK kërkoi që ZKM të lëshojë opinion.

- **Zyra e Kryeministrit - Sqarim:** Zyra Ligjore e ZKM nuk mund të lëshojë opinion ligjor për një ligj të cilin nuk e ka hartuar vetë, kur sponzorizues është MD. Sponzorizuesi e ka për obligim që të ofrojë sqarime për ato dispozita.
- **Dhoma e Tregtisë Industrisë së Kosovës** - Ligji duhet të interpretohet ashtu që të ndihmohen bizneset. Meqë sponzorizuesi është prezent në këtë takim, le të deklarohet rreth këtyre paqartësive.

Ministria e Ekonomisë, Departamenti për Miniera dhe Minerale (ME)

- Në sektorin minerar janë të punësuar 22 mijë puntorë aktivë dhe më shumë se 100 mijë punëtorë të kontraktuar. Është sektori i tretë që i jep më shumë buxhetit të shtetit pas ATK dhe Doganës. Duhet të trajtohet me shumë prioritet.



Si propozim, ME tha se ZKM duhet t'i lëshojë një letër KPMM-së, në mënyrë që të jepet licenca për dy vite. Ndërkaq, për zonat me interes të veçantë, ka mundësi që ZKM të lëshojë një letër për interes të veçantë dhe KPMM me atë arsyetim të jep licencën për atë zonë.

- **Sqarim nga ZKM:** Cfarëdo opinionit, leje apo dicka tjetër lidhur me këtë ligj, duhet të jepen duhet të jepen nga sponsorizuesi (MD) e jo nga Zyra Ligjore e ZKM-së.
- **Pyetje/propozim MDA** - A ekziston mundësia që këto investime të trajtohen si investime strategjike, në mënyrë që të tejkalohen problemet që ka sjellë ky ligj?

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM)

Është hera e parë që marrim pjesë në një diskutim të tillë për pronën publike. Është në dorën e sponsoruesit të ligjit që të largojë këtë ngërç. Ne jemi të gatshëm që të bashkëpunojmë me MD që të zvogëlohen këto procedura burokratike. Së bashku të arrijmë deri të një zgjidhje që të lehtësojë aplikacionet dhe licencimet e të gjithë sektorit minerar, në mënyrë që të zhvillohet ky sektor, por gjithmonë duke i respektuar kornizat ligjore të shtetit.

Duhet të ketë ekspert të kësaj fushe që të trajtoj këtë problematikë. Së pari duhet të evidentohet ngërqi pastaj të trajtohet problemi.

Biznes privat - Propozime

1. Nëse MD, si sponsorues i ligjit, ka vullnet që të nxjerrë opinion ligjor për vazhdimin e procedurave ashtu sic kanë qenë para nxjerrjes së ligjit, kjo do të ndihmonte të blejmë kohë deri sa të nxirren aktet nënligjore përkatëse.
2. Të diskutohet këtu edhe nëse është e gatshme edhe MBPZHR, respektivisht APK, që të pranojë atë opinion ligjor dhe të vazhdojë zbatimin e procedurës sic ka qenë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural



Opinion i ligjor nuk ka fuqi detyruese. Nuk është as interpretim, atë e bën Kuvendi. Edhe nëse e lëshon atë opinion, APK duhet të vendosë nëse pranon ta zbatojë apo jo.

- Propozim: Zgjidhja ma shpejtë do të ishte të formohet një grup punës dhe të thirren ekspert të të gjitha fushave dhe me procedure të përshtatshme të bëhet plotësim-ndryshimi i ligjit.
- Në draftin e parë të ligjit, që më pas u ndryshua, neni 25 thoshte se zbatohen dispozitat e këtij ligji *“përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe”*.

Për më tepër, edhe nëse funksionalizohet Njësia, prapë do të ishte vështirë të fillojë puna menjëherë. Prapë nevojitet numër i madh i stafit, ka numër të madh të kërkesave, të kontratave, mbikëqyrja, shkelja, zbatimi etj.

Xhevat Azemi, Ekspert i angazhuar në draftimin e Ligjit për Pronën Publike

Juristët duhet të dinë dallimin mes ligjeve të përgjithshme dhe atyre të veçanta.

Ky është ligj, është ligj i përgjithshëm, është kornizë, që nuk i rregullon çështjet minerare. I rregullon procedurat e përtëgjithshme të qiradhënie, licencave për pronë publike, gjithçka rreth administrimit të pronës publike. Ky ligj vlen për të gjitha institucionet që merren me menaxhim, administrim apo janë pronar të pronave publike. Ligjet e vecanta duhet të harmonizohen me këtë ligj. Janë 12 ligje që lidhen me pronën publike. Për atë është vendosë që Njësia të jetë qëndore për trajtimin e këtyre. Para këtij, nuk ka pasur ligj në të cilën ka mund të thirret ZKM lidhur me pronën.

Ligji nuk thotë se Njësia mund të bëjë kontratë të dhënies në shfrytëzim, përveç pronave që me ligj të veçantë nuk i administrojnë askush. Ka prona që nuk ka ligj të veçantë për administrim të tyre.

Si shembull, Kroacia e ka nxjerrë një ligj të ngjashëm në vitin 2010. Po atë vit kanë krijuar edhe agjencion për administrimin e pronave publike dhe një njësi që është marrë me privatizim. Kompetencat e administrimit të pronave publike i kanë kaluar ministrisë më vonë.



Tani, neni 25 krijon probleme. Deri në shtator 2018, përpilimi i atij paragrafi ka qenë ndryshe, gjë që nuk do të lejonte të krijohet ky problem.

Megjithatë, ligji pastaj e ka një nen që thotë “procedurat për dhënien në shfrytëzim/këmbim përcaktohen me një akt nënligjor”. Po të ishte funksionalizuar njësia kur është nxjerr vendimi, nuk do të ishte krijuar ky problem, sepse do të ishte dhënë pëlqimi nga njësia.

Nenet 1, 2, 3, 6 (paragrafi 3, 17, 1, 2, 4, 5) dhe neni 30, i përmendin që institucionet qendore, ndërmarrjet publike, njesitë e qeverisë lokale administrojnë dhe japin në shfrytëzim pronat.

Propozimi:

- 1) Amandamenti i nenit 25.1 të kthehet si ka qenë (Mendoj që ka mbulesë edhe te Neni 6.3 dhe te neni 17);
- 2) Të përpilohen dhe të hyjnë në fuqi 3 udhëzimet administrative që i kërkon ligji;
- 3) Të funksionalizohet Njësia;

Ministria e Drejtësisë

Jeta institucionale nuk mund të blloket për shkak të mos-ekzistimit të një Njësie, sepse edhe shtetet e tjera kanë patur probleme për shkak të kolizioneve të ligjeve.

- Si MD, kemi themeluar grup punës dhe kemi filluar me hartimin e dy akteve nënligjore dhe kemi kërkuar eksperizë për zgjidhjen e këtij problem. Deri në atë kohë institucionet mund të veprojnë sipas legjislacionit përkatës.

Ministria e Ekonomisë

Jeta institucionale nuk duhet bllokuar, mirëpo në sektorin minerar është bllokuar tashmë. Kjo sepse, KPMM-ja nuk i jep licenca sektorit, sepse vazhdon tek MBZHR pastaj te APK-ja për të kërkuar leje për qira dhe e gjithë kjo pastaj e bllokon jetën institucionale të sketorit minerar.



APK

Neni 17.4, përcakton se për dhënie me qira/kembim të pronave duhet të mirret pëlqimi nga Njësia për administrimin e pronës publike. Kjo lidhet me nenin 25.

Neni 25. 2 e përcakton që mirret edhe me inspektim edhe me mbikëqyrje edhe me punë të tjera, por fillimisht do ta administrojë pronën publike. Kjo pikë ka bërë që APK të ndalet dhe të kërkoj prej organeve tjera se çka duhet bërë dhe ende nuk kemi marrë përgjigje.

Biznes privat

- Mos harmonizimi i ligjeve është bërë trend, sepse këto procese kanë filluar me 2014.
- Ne jemi investitori direkt i huaj më i madhi në Kosovë, dhe kemi parë mundësi të investojmë edhe në sektorin e energjisë për çka prapë do të përballemi me të njëjtin problem si ky për pronën publike.
- Jemi duke konsideruar investime në rajon ku ka më pak “red-tape” në vlerë 15-20 mil euro, e që kjo nuk do të ishte e mirë për ekonominë.
- Ne furnizojmë 55% të tregut. Me këtë ligj nuk është prekur vetëm industria jonë, por e gjithë industria e ndërtimit. Jemi detyruar të marrim 3 mijë ton gur nga Maqedonia, sasi që është e pamundur të sjelljet për një ditë, prandaj ose duhet të zgjidhet problemi ose jemi të detyruar të mbyllim fabrikën në Kosovë.

Ministria e Drejtësisë

- Detyra ime sot ka qenë që t’i marr të gjitha opinionet e akterëve dhe këto do t’ia përcjelli ministres.
 - o Duhet të gjendet zgjidhje, qoftë shkresë formale, qoftë vendim i Qeverisë, trupë kolegjiale, kabineti ministror, ndoshta me një deklaratë mund të thuhet që deri në finalizimin e këtyre akteve të vazhdohet siç ka qenë.



- Prej këtij diktumi, të merren disa pika që na shërbejnë për të inicuar procedurën për plotësim-ndryshimin e ligjit.
- Duhet patjetër të dalim nga kjo situatë. Nuk bën të bllokohemi për shkak të pengesave ligjore.
- Besoj që Qeveria do të reflektojë në këtë drejtim, dhe do t'i raportojë institucioneve gjegjëse.

Pyetje nga biznes privat

1. A mund ta kemi takimin e radhës lidhur me këtë çështje, nëse po kur?
2. A mund të kontribuojmë ne këtu diçka për këtë çështje?

Sekretariati i KKEI

Pasi të diskutohen pikat e sotme brenda secilit institucion, në takimin e radhës mund të flasim për zhvillimet pas bisedës, dhe nëse ka dilemë nga ana e vendimmarrësve se çfarë veprimi duhet ndërmarrë, ne si Sekretariat prapë do të organizojmë një takim të tillë dhe të diskutojmë.

Ministria e Drejtësisë

Të gjitha shqetësimet që janë diskutuar sot, do t'i raportohen direkt ministres dhe niveli politik do të reflektojë. Rekomandimet duhet të jenë bindëse. Situata është problematike dhe kërkon zgjidhje të shpejtë, por edhe ministria është e interesuar që ta zgjidh këtë problem.

- ZKM – këto rekomandime do t'i përcillen edhe Sekretarit të përgjithshëm në ZKM.

Biznes privat



- Ky problem ekziston që ca kohë, prandaj vetëm shqetësimi nuk është i mjaftueshëm. Ne kërkojmë zgjidhje.

KPMM

Sa herë të përpilohen ligje që prekin sektorin minerar, duhet të marrin pjesë ekspertët e fushës së sektorit minerar.

APK

- Çfarë nënkupton “administrimi i pronës publike”? Le ta shpjegojë dikush se cka është saktësisht kompetenca e Njësisë.
- Neni 17.8 thotë: “Cdo kontratë që është në kundërshtim me këtë nen, është e pavlefshme”. Çdo kontratë duhet të harmonizohet me këtë nen, në mënyrë që të bëhet kontrata.

Pyetje nga Ministria e Drejtësisë, drejtuar APK-së:

A mendoni se është mirë që APK të japë pronë me qira ma shumë sesa e parasheh Ligji për Pronën Publike?

Përgjigje nga APK: Po, është e nevojshme, sepse askush nuk shpreh interesim të investojë në Kosovë pa i pasur 30 vjet të garantuara me kontratë. Sepse, jetëgjatësinë e projektit e kanë 30 vjet. Një gjë e tillë kërkohet nga investitorët e energjisë.

Te pjesa minerare: me UA është vendosur, sa të ketë licencë, aq të zgjat edhe kontrata, në mënyrë që të jetë harmoni me KPMM-në, sepse pesëvjeçari ka qenë shumë i shkurtër për profesionistët.